



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

URDHËR

Nr. 1116 /Prot, datë 20.06.2017

Për mirëmenaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike

Bazuar në Ligjin nr.9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, në VKM Nr.542, datë 27.07.2005 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar,

U r d h ë r o j:

1. Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së të kontrollojnë hyrjet e reja në skemën e ndihmës ekonomike të muajit Maj dhe Qershor 2017.
2. Të kërkojnë zyrtarisht nga bashkitë/njësitë administrative, dosjet e hyrjeve të reja dhe të verifikojnë dokumentacionin.
3. Në rast të konstatimit të dokumentacionit në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, Drejtoria Rajonale dërgon shkresë zyrtare bashkisë/njësisë administrative duke lënë detyrë largimin e tyre nga skema e ndihmës ekonomike.
4. Për problemet e konstatuara në Muajin Maj të raportohet pranë Drejtorisë së Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK brenda datës 15.06.2017. Për problemet e konstatuara në Muajin Qershor të raportohet brenda datës 15.07.2017.
5. Ngarkohen Drejtoritë Rajonale të SHSSH dhe Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, për zbatimin e këtij urdhëri.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Etleva Bisha